13. Moduli “Përcaktimi i vëllimit të dheut në një objekt inxhinierik”

Drejtimi: Gjeodezi
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 13

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe Kodi	PËRCAKTIMI I VËLLIMIT TË DHEUT NË NJË OBJEKT INXHINIERIK	M-03-552-20
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të përcaktuar vëllimin e dheut për hapjen e transhesë së themelit	
Kohëzgjatja e modulit	32 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet e praktikës profesionale të kl.12 të drejtimit “Gjeodezi”, niveli IV i KSHK.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RN 1 Nxënësi përcakton largësinë ndërmjet izoipseve. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës sipas kushteve teknike;- të llogarisë largësinë ndërmjet izoipseve me saktësinë e duhur;- të vizatojë izoipset që paraqet planin e skarpatit me saktësinë e duhur;- të heqë vijën e punimeve zero sipas kërkesave teknike;- të respektojë udhëzimin për rregullat e mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjeteve të punës e mjedisit. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli.	
	<p>RN 2 Nxënësi përcakton vëllimin e punimeve. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës sipas kushteve teknike;- të ndajë figurën në trekëndësha ose trupin e themelit në trupa gjeometrik me saktësinë e duhur;- të llogarisë sipërfaqet e këtyre trekëndëshave me formulat sipas figurës së formuar;- të llogarisë vëllimin e përgjithshëm me formulën përkatëse;- të respektojë udhëzimin për rregullat e mbrojtjes	

në punë dhe të ruajtjes së mjeteve të punës e mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me goje
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset e kabinetit të gjeodezisë dhe oborrit të shkollës.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për të llogaritur vëllimin e dheut në një objekt.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete për matjet në terren dhe për të llogaritur vëllimin e dheut në një objekt fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me procedurat e matjes në terren për të llogaritur vëllimin e dheut në një objekt.
- Nxënësit duhet të angazhohen në llogaritje konkrete të thjeshta ekonomike për të llogaritur vëllimin e dheut në një objekt.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për të llogaritur vëllimin e dheut në një objekt si dhe për të kryer llogaritje të thjeshta ekonomike.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisje dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedise në kabinetin e gjeodezisë e në oborrin e shkollës
 - Plan topografik i zonës ku do të ndërtohet objekti, makina llogaritëse me funksione trigonometrike, pajisje kancelarie, shkallë gjatësore.
 - Formular, udhëzuesa, në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
 - Manualet e preventivimit dhe për zbrërthimin e kostos për punimet gjeodezike.
 - Përmbledhje të legjislacionit që lidhet me punimet gjeodezike.
-

14. Moduli “Matja e largësive në poligonometri me bazë Zeiss”

Drejtimi: Gjeodezi
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 13

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe Kodi	MATJA E LARGËSIVE NË POLIGONOMETRI ME BAZË ZEISS	M-03-553-20
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit të zbatojnë mënyrat e matjes së largësive në poligonometri, me bazë Zeiss (vendosjes së bazës parallaktike për largësi të ndryshme).	
Kohëzgjatja e modulit	32 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet e praktikës profesionale të kl.12 të drejtimit “Gjeodezi”, niveli IV i KSHK.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RN 1 Nxënësi vendos bazën parallaktike për largësi 300-500 m për variantin e parë. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të përgatisë vendin dhe mjetet e punës sipas kushteve teknike;– të skicojë variantin e parë të vendosjes së bazës parallaktike sipas kërkesave teknike;– të vendosë bazën ndihmëse në terren për variantin e parë dhe fiksojë pikat e bazës dhe brinjës së poligonometrisë;– të masë këndet me teodolit në të dyja anët e latës parallaktike dhe në pikën C me saktësinë e duhur;– të llogarisë largësinë me formulat përkatëse;– të respektojë udhëzimin për rregullat e mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjeteve të punës e mjedisit. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli.	
	<p>RN 2 Nxënësi vendos bazën parallaktike për largësi 300 - 500 m për variantin e dytë. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të përgatisë vendin dhe mjetet e punës sipas kushteve teknike;– të skicojë vendosjen e bazës parallaktike për variantin e dytë sipas kërkesave teknike;– të vendosë bazën ndihmëse në terren për variantin e dytë dhe fiksojë pikat e bazës dhe brinjës së poligonometrisë sipas kërkesave teknike;	

- të masë këndet me teodolit në të dyja anët e latës parallaktike dhe në pikën C me saktësinë e duhur;
- të llogarisë e largësinë me formulat përkatëse;
- të respektojë udhëzimin për rregullat e mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjeteve të punës e mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi vendos bazën parallaktike për largësi 600-800 m

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë kushtet dhe mjetet e punës sipas kërkesave teknike;
- të skicojë vendosjen e bazës parallaktike për largësi 600-800 m sipas kërkesave teknike;
- të vendosë bazën ndihmëse në terren dhe fiksojë pikat e bazës dhe brinjët A dhe B të brinjëse së poligonometrise sipas kërkesave teknike;
- të masë këndet me teodolit në të dyja anët e latës parallaktike dhe në pikat A dhe B të brinjës së poligonometrisë me saktësinë e duhur;
- të respektojë udhëzimin për rregullat e mbrojtjes në punë
- dhe të ruajtjes së mjeteve të punës e mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Nxënësi kryen llogaritje të thjeshta për matjen e largësive në poligonometri me bazë Zeiss.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të njehsojë kostot në matjen në terren dhe llogaritje për mënyrën e matjes së largësive në poligonometri me bazë Zeiss, si dhe përbërsit e kostove sipas manualit përkatës;
- të njehsojë preventivin e punës dhe koston për materialet dhe instrumentet sipas manualit përkatës;
- të njehsojë koston e punës (pagat, sigurimet shoqërore etj.) sipas manualit përkatës;
- të njehsojë kostot e tjera (transport etj.) sipas manualit përkatës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me goje
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin

Ky modul duhet të trajtohet në mjediset e kabinetit të gjeodezisë dhe oborrit të shkollës.

- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për matjen e largësive në

e nxënësve

- poligonometri me bazë Zeiss.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete për matjen e largësive në poligonometri me bazë Zeiss fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
 - Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me procedurat e matjes në terren të largësive në poligonometri me bazë Zeiss.
 - Nxënësit duhet të angazhohen në llogaritje konkrete të thjeshta ekonomike për matjet në terren të largësive në poligonometri me bazë Zeiss.
 - Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për matjen e largësive në poligonometrin me bazë Zeiss, si dhe për të kryer llogaritje të thjeshta ekonomike.
 - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisje dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedise në kabinetin e gjeodezisë e në oborin e shkollës.
 - Teodolit, latë parallaktike, kunjja, makina llogaritëse me funksione trigonometrike, pajisje kancelarie.
 - Formular, udhëzuesa, në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
 - Manualet e preventivimit dhe për zberthimin e kostos për punimet gjeodezike.
 - Përmbledhje të legjislacionit që lidhet me punimet gjeodezike.
-

IX. Programi orientues i provimeve përfundimtare

Përmbajtja e programit për Provimin e Praktikës Profesionale të integruar

Programi orientues për provimin e praktikës profesionale të integruar, në kualifikimin profesional "Gjeodezi", **Niveli IV në KSHK** është hartuar duke u mbështetur në listën e kompetencave profesionale dhe në modulet e detyruara të praktikës profesionale, që përmban Skeletkurrikuli përkatës.

a) **Lista e kompetencave profesionale** për të cilat duhet të vlerësohen nxënësit, **detyrat e punës** dhe **pikët** për secilën kompetencë:

Njohuri dhe Kompetenca Bazë Profesionale			
A.	Njohuri profesionale	Detyrat e punës	Pikët
1	Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit në punë.	Në të gjitha detyrat.	1
2	Të përgatisë mjetet dhe vendin e punës.	Në të gjitha detyrat.	1
3	Të lexojë planet, hartat dhe projektet.	Në të gjitha detyrat.	1
4	Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike.	Në të gjitha detyrat.	1
5	Bashkëbisedimi profesional.	Në të gjitha detyrat.	1
B.	Kompetencat Bazë profesionale	Detyrat e punës	Pikët
1.	Të kryejë matjet me mjete të thjeshta.	Detyra 1: Matja e vijës së pjerrësisë me eklimetër në oborrin e shkollës.	2
		Detyra 2: Matja e azimitit magnetik të një drejtimi me busull në oborrin e shkollës.	2
2	Të përdorë teodolitin.	Detyra 3: Realizimi i kontrollit të kushtit të teodolitit $LL \perp VV$ në kabinetin e gjeodezisë ose në oborrin e shkollës .	3
		Detyra 4: Realizimi i kontrollit të kushtit të kolimacionit. $ZZ \perp HH$ në kabinetin e gjeodezisë ose në oborrin e shkollës .	5
3	Të masë këndet.	Detyra 5: Matja e këndeve me metodën me seri në oborrin e shkollës.	5

		Detyra 6: Matja e këndeve vertikale në oborin e shkollës.	5
4	Të masë largësitë.	Detyra 7: Realizimi i matjes së largësisë me mënyrën optike në oborin e shkollës.	5
5	Të kryejë matjet për poligonin e hapur pa orientim.	Detyra 8: Kontrolli i mbylljes së poligonit të hapur në ambientin e kabinetit të gjeodezisë.	3
6	Të masë disnivelet.	Detyra 9: Realizimi i matjes së disnivelit midis dy pikave me kuotë të njohur, me mënyrën gjeometrike, në oborin e shkollës.	5
7	Përdorimi i hartës në terren.	Detyra 10: Përcaktimi i vendndodhjes në hartë në ambientet e kabinetit të gjeodezisë.	2
8	Të kryejë punimet me emërtesën e hartës, të nxjerrë të dhënat e të masë sipërfaqet.	Detyra 11: Nxjerrja e koordinatave ortogonale nga harta në ambientet e kabinetit të gjeodezisë.	5
		Detyra 12: Nxjerrja e kuotës së një pike mes dy izoipseve nga harta në ambientet e kabinetit të gjeodezisë.	3
9	Të kryejë matjen në terren për të bërë lidhjen me rrjetin gjeodezik.	Detyra 13: Matjet për përcaktimin koordinatave të pikës me metodën e prerjes para në oborin e shkollës.	5
10	Të kryejë procesin e rilevimit me sy.	Detyra 14: Matja e një distance me hapa në oborin e shkollës.	2
11	Të kryejë rilevimin ortogonal të zonës.	Detyra 15: Rilevimi ortogonal i oborrit të shkollës. (duke matur 5 pika situacioni)	5
12	Të kryejë punimet fushore dhe kamerale në rilevimin takeometrik.	Detyra 16: Realizimi i llogaritjes së një libeze takeometrike me pesë pika në kabinetin e gjeodezisë.	5
13	Të piketojë një rrugë me kthesa	Detyra 17: Llogaritja e elementeve të kthesës në ambientet e kabinetit të gjeodezisë.	6

14	Të kryejë piketimin e objekteve në terren.	Detyra 18: Realizimi i piketimit të një objekti në terren me prerje këndore në oborrin e shkollës.	5
15	Të kryejë nivelimin e sipërfaqeve të ndërtimit.	Detyra 19: Realizimi i nivelimi të sipërfaqes së ndërtimit me katrorë në oborrin e shkollës.	5
16	Të kryejë piketimin e kanaleve.	Detyra 20: Realizimi i piketimit të kanalit me kuotë të kërkuar në oborrin e shkollës.	6
17	Të kryejë matje për projektimin e rezervuarit.	Detyra 21: Llogaritja e volumit të rezervuarit në ambientet e kabinetit të gjeodezisë.	5
18	Të plotësojë dokumentet e kadastrës së tokave.	Detyra 22: Plotësimi i librit të skicave dhe i librit të tokës në kabinetin e gjeodezisë.	6
		Shuma	100

b) Skema e vlerësimit me nota:

Pikët e fituara	Notat
0 ÷ 40	4
41 ÷ 50	5
51 ÷ 60	6
61 ÷ 70	7
71 ÷ 80	8
81 ÷ 90	9
91 ÷ 100	10

Shënime:

- Provimi praktik do të realizohet me anë të metodës së vlerësimit të nxënësve në “*procesë pune dhe llogaritjet përkatëse*”, në mënyrë individuale, në kabinetin e gjeodezisë (për pjesën llogaritëse) dhe në oborrin e shkollës (për pjesën e aplikimit praktik të procesit të matjes). Për detyrat të cilat janë veprimtari praktike që kërkojnë grup pune me 2 ose 3 persona, do të jetë mësuesi që do t’ia sigurojë këtë kusht me nxënës të tjetër nga grupi. Roli i nxënësit të dytë do të jetë ndihmës që do të procedojë sipas urdhrave të punës që merr nga nxënësi që po testohet.
- Koha për realizimin e të gjitha detyrave duhet të jetë jo më shumë se 3 orë, në përputhje kjo me Rregulloren e Zhvillimit të Provimeve Përfundimtare në fuqi.
- Në çdo detyrë respektimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit duhet të jenë domosdoshmërisht të përfshira në vlerësim.
- Në vlerësimin e kompetencave profesionale, rekomandohet t’i lihet hapësirë për vlerësim dhe bashkëbisedimit profesional ndërmjet anëtarëve të komisionit dhe

nxënësit, pasi ai është element i rëndësishëm i secilës prej kompetencave të listuara. Komisioni i vlerësimit duhet të hartojë paraprakisht pyetjet për bashkëbisedimin profesional.

- Nxënësit duhet të punojnë në mënyrë të pavarur, pa ndërhyrjen e komisionit duke u testuar/vlerësuar në një nga proceset e punës për çdo detyrë, kjo edhe për shkak të kohës së kufizuar 3 orë të provimit praktik.
- Për çdo detyrë, komisioni i vlerësimit duhet të përgatisë instrumentet përkatëse të vlerësimit sipas kompetencave profesionale. Instrumenti i vlerësimit për secilën detyrë duhet të përfshijë të gjitha hapat e realizimit të saj.
- Instrumenti i vlerësimit duhet të përfshijë në përmbajtjen e tij edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale si vetëkontrolli, përgjegjshmëria, manifestimi i guximit, angazhimi fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme. Gjithashtu, komisioni duhet të hartojë dhe një listë kriteresh vlerësimi për produktin përfundimtar.
- Për çdo detyrë komisioni duhet të përgatisë udhëzuesin e përmbushjes për nxënësit, ku do të jepen hapat për realizimin e detyrës përkatëse.

Udhëzime për realizimin e Detyra 1: Matja e vijës së pjerrësisë me eklimeter në oborrin e shkollës.

Vendi ku do të realizohet: Në oborrin e shkollës.

Mjetet e punës që nevojiten: Eklimetër, librezë fushore.

Për kryerjen e detyrës nxënësi ka nevojë për: Detyra kryhet individualisht.

Nga mësuesi do ti përcaktohen në terren maksimalisht 3 vija pjerrësie të ndryshme për matje.

Vijat e pjerrësisë të jenë mbi horizont dhe nën horizont.

Vlerësimi do të përqendrohet :

1. Nxënësi duhet të përdorë saktë instrumentin – eklimetër.
2. Të japë leximin e saktë të këndit të vijës së paracaktuar nga mësuesi.
3. Të plotësojë librezën fushore.

Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi të verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e të gjitha proceseve të punës si dhe ndjekja e rregullave të sigurimit teknik në punë dhe ruajtjes së mjedisit.

Vlerësimi i nxënësve bëhet më anë listës së kontrollit të përgatitur më parë.

Udhëzime për realizimin e Detyra 2: Matja e azimutit magnetik të një drejtimi me busull në oborrin e shkollës.

Vendi ku do të realizohet: Në oborrin e shkollës.

Mjetet e punës që nevojiten: Busull, librezë fushore.

Për kryerjen e detyrës nxënësi ka nevojë për : Detyra kryhet individualisht.

Nga mësuesi do ti përcaktohen në terren maksimalisht 3 drejtime të ndryshme për matje.

Drejtimet të jenë të përkatësisht të spostuara me mbi 60° nga njëra-tjetra.

Vlerësimi do të përqendrohet :

1. Nxënësi duhet të përdorë saktë instrumentin – busull.
2. Të përgatisë vendin e punës për matjen me busull.
3. Të japë leximin e saktë të Azimutit magnetik të drejtimeve të paracaktuar nga mësuesi.
4. Të plotësojë librezën fushore.

Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e të gjitha proceseve të punës si dhe ndjekja e rregullave të sigurimit teknik në pune dhe ruajtjes së mjedisit.

Vlerësimi i nxënësve bëhet më anë listës së kontrollit të përgatitur më parë.

Udhëzime për realizimin e Detyra 3: Realizimi i kontrollit të kushtit të teodolitit $LL\perp VV$ në kabinetin e gjeodezisë ose në oborrin e shkollës.

Vendi ku do të realizohet: Në oborrin e shkollës ose në kabinetin e gjeodezisë.

Mjetet e punës që nevojiten: Teodolit, trekëmbësh, këmbalec.

Për kryerjen e detyrës nxënësi ka nevojë për: Detyra kryhet individualisht.

Detyra kryhet si veprimtari praktike individuale dhe nxënësit i mundësohet skema (pankarte) e boshteve te Teodolitit

Vlerësimi do të përqendrohet

1. Nxënësi duhet të ndjekë procedurën e horizontimit, kontrollit te kushtit dhe të rektifikimit të instrumentit – Teodolit.
2. Të përgatisë vendin e punës (përdorimin e këmbalecit kur detyra kryhet ne kabinetin e gjeodezisë).
3. Të realizojë horizontimin e instrumentit, të kontrollojë kushtin dhe ta rektifikojë instrumentin si kusht bazë për vënien ne punë të instrumentit.

Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e të gjitha proceseve të punës si dhe ndjekja e rregullave të sigurimit teknik në pune dhe ruajtjes së mjedisit.

Vlerësimi i nxënësve bëhet më anë listës së kontrollit të përgatitur më parë.

Udhëzime për realizimin e Detyra 4: Realizmi i kontrollit të kushtit të kolimacionit $ZZ\perp HH$ në kabinetin e gjeodezisë.

Vendi ku do të realizohet: Në oborrin e shkollës ose në kabinetin e gjeodezisë.

Mjetet e punës që nevojiten: Teodolit, trekëmbësh, këmbalec, librezë e matjes.

Për kryerjen e detyrës nxënësi ka nevojë për : Detyra kryhet individualisht.

Detyra kryhet si veprimtari praktike individuale dhe nxënësit i mundësohet ambienti i përshatshëm për matjet e nevojshme për kontrollin e kushtit. (Pankarta e boshteve kryesore të teodolitit)

Vlerësimi do të përqendrohet:

1. Nxënësi duhet të ndjekë procedurën e horizontimit, kontrollit të kushtit dhe të rektifikimit të instrumentit – Teodolit.
2. Të përgatisë vendin e punës duke përcaktuar pikën e matjes së kontrollit, (përdorimin e këmbalecit kur detyra kryhet ne kabinetin e gjeodezisë), .
3. Të realizojë horizontimin e instrumentit, të kontrollojë kushtin dhe ta rektifikojë instrumentin si kusht bazë për të pasur një instrument te kolauduar dhe për të arritur saktësinë e kërkuar të procesit të punës.

Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e të gjitha proceseve të punës si dhe ndjekja e rregullave të sigurimit teknik në pune dhe ruajtjes së mjedisit.

Vlerësimi i nxënësve bëhet më anë listës së kontrollit të përgatitur më parë.

Udhëzime për realizimin e Detyra 5: Matja e këndeve me metodën me seri në oborrin e shkollës.

Vendi ku do të realizohet : Në oborrin e shkollës dhe në kabinetin e gjeodezisë.

Mjetet e punës që nevojiten: Teodolit, trekëmbësh, këmbalec, librezë e matjes, tre zhalona.

Për kryerjen e detyrës nxënësi ka nevojë për: Detyra kryhet ne grup.

Detyra kryhet si veprimtari praktike e 2 ose 3 nxënësve. Për këtë nxënësit i mundësohet ambienti i përshtatshëm për matjet e nevojshme, si pasja e dy nxënësve ndihmës për matjen e këndeve në seri. Nga mësuesi i përgatitet librezja fushore (tabela) dhe i përcaktohen drejtimet për matjen e këndeve.

Vlerësimi do të përqendrohet:

1. Të përgatisë vendin e punës duke përcaktuar pikën e matjes (stacionimin) duke kryer centrimin saktë.
2. Nxënësi duhet të ndjekë procedurën e horizontimit të instrumentit, të matjes së drejtimeve me R_M dhe R_D .
3. Të realizojë ne kabinetin e gjeodezisë llogaritjen e këndit me tabelë sipas metodës me seri, duke u bazuar në vlerat e drejtimeve të matura.

Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e të gjitha proceseve të punës si dhe ndjekja e rregullave të sigurimit teknik në pune dhe ruajtjes së mjedisit.

Vlerësimi i nxënësve bëhet më anë listës së kontrollit të përgatitur më parë.

Udhëzime për realizimin e Detyra 6: Matja e këndeve vertikale në oborrin e shkollës.

Vendi ku do të realizohet : Në oborrin e shkollës dhe në kabinetin e gjeodezisë.

Mjetet e punës që nevojiten: Teodolit, trekëmbësh, këmbalec, librezë e matjes, tre zhalona.

Për kryerjen e detyrës nxënësi ka nevojë për : Detyra kryhet ne grup.

Detyra kryhet si veprimtari praktike e 2 ose 3 nxënësve. Për këtë nxënësit i mundësohet ambienti i përshtatshëm për matjet e nevojshme, si pasja e dy nxënësve ndihmës për matjen e këndeve vertikale. Nga mësuesi i përgatitet librezja fushore (tabela) dhe i përcaktohen 2 drejtime për matjen e këndit vertikal.

Vlerësimi do të përqendrohet:

1. Të përgatisë vendin e punës duke përcaktuar pikën e matjes (stacionimin) dhe duke kryer centrimin.
2. Nxënësi duhet të ndjekë procedurën e horizontimit të instrumentit, si dhe të matjes së këndit vertikal me dy pozicionet e dylbisë (R_M dhe R_D .)
3. Të realizojë ne kabinetin e gjeodezisë llogaritjen e këndit vertikal me tabelë, duke u bazuar në vlerat e drejtimit të matur me R_M dhe R_D .

Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e të gjitha proceseve të punës si dhe ndjekja e rregullave të sigurimit teknik në pune dhe ruajtjes së mjedisit.

Vlerësimi i nxënësve bëhet më anë listës së kontrollit të përgatitur më parë.

Udhëzime për realizimin e Detyra 7: Realizimi i matjes së largësisë me mënyrën optike në oborrin e shkollës.

Vendi ku do të realizohet: Në oborrin e shkollës.

Mjetet e punës që nevojiten: Teodolit, trekëmbësh, , librezë e matjes, lata.

Për kryerjen e detyrës nxënësi ka nevojë për : Detyra kryhet ne grup.

Detyra kryhet si veprimtari praktike e 2 ose 3 nxënësve. Për këtë nxënësit i mundësohet ambienti i përshtatshëm për matjet e nevojshme, si dhe pasja e dy nxënësve ndihmës për matjen e distancës me metodën optike. Nga mësuesi i përgatitet librezja fushore (tabela) dhe i përcaktohen 2 deri ne 3 pika të distancave të ndryshme nga vendi i centritit që të maten distancat me metodën optike.

Vlerësimi do të përqendrohet :

1. Të përgatisë vendin e punës duke përcaktuar pikën e matjes (stacionimin) si dhe duke kryer centrimin.
2. Nxënësi duhet të ndjekë procedurën e horizontimit të instrumentit, si dhe të leximit ne latë me tre fije (S, M, P).
3. Të realizojë në kabinetin e gjeodezisë llogaritjen e distancës me metodën optike për çdo pikë, duke u bazuar në vlerat e marra nga leximi në latë.

Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e të gjitha proceseve të punës si dhe ndjekja e rregullave të sigurimit teknik në punë dhe ruajtjes së mjedisit.

Vlerësimi i nxënësve bëhet më anë listës së kontrollit të përgatitur më parë.

Udhëzime për realizimin e Detyra 8: Kontrolli i mbylljes së poligonit të hapur në ambientin e kabinetit të gjeodezisë .

Vendi ku do të realizohet: Në ambientin e kabinetit të gjeodezisë .

Mjetet e punës që nevojiten: Libreza fushore e matjeve, makinë llogaritëse, mjetet e vizatimit.

Për kryerjen e detyrës nxënësi ka nevojë për: Detyra kryhet individualisht.

Nga mësuesi do t'i jepen të dhënat në formularin përkatës të poligonit të hapur. Nxënësi kryen veprimet llogaritëse të poligonit të hapur me tabelën përkatëse, duke llogaritur këndin e drejtimit, ndryshimin e koordinatave paraprake, këndet e drejtimit të korrigjuara, ndryshimin e koordinatave përfundimtare, koordinatat e pikave.

Vlerësimi do të përqendrohet:

1. Nxënësi duhet të llogarisë këndet e drejtimit të vijave të poligonit.
2. Ndryshimin e koordinatave paraprake.
3. Këndet e drejtimit të korrigjuara.
4. Ndryshimin e koordinatave përfundimisht.
5. Koordinatat e pikave të poligonit pa orientim.

Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e të gjitha proceseve të punës si dhe ndjekja e rregullave të sigurimit teknik në punë dhe ruajtjes së mjedisit.

Vlerësimi i nxënësve bëhet më anë listës së kontrollit të përgatitur më parë.

Udhëzime për realizimin e Detyra 9: Realizimi i matjes së disnivelit midis dy pikave me kuotë të njohur, me mënyrën gjeometrike.

Vendi ku do të realizohet : Në oborrin e shkollës.

Mjetet e punës që nevojiten : Nivelë, latë, libreza fushore e matjeve,

Për kryerjen e detyrës nxënësi ka nevojë për : Detyra kryhet në grupe.

Nga mësuesi do ti përcaktohen pikat A dhe B në terren midis të cilave do të matet disniveli. Për këtë nxënësit i mundësohet pasja e dy nxënësve ndihmës për matjet në terren. Grupi i

nxënësve kryen procesin e matjeve duke vendosur nivelën midis dy pikave A dhe pikës ndërmjetëse 1 (nivelim nga mesi). Merr leximin në latën e vendosur ne piken A (mbrapa), merr leximin e vendosur ne pikën 1 (para). Këto lexime i vendos ne librezën fushore. Kështu vepron me radhë deri sa të shkojë tek pika B, duke e spostuar nivelën në varësi të kushteve të terrenit.

Vlerësimi do të përqendrohet:

1. Nxënësi duhet të dije te nivelejtë me nivelën vetë-horizontuese me saktësinë teknike .
2. Të marrë leximet në çdo pikë (mbrapa-m, para-p).
3. Leximet e marra në latë (mbrapa-m, para-p) t'i regjistrojë në vendin e duhur në librezën fushore.
4. Të kryej kontrollin e matjeve dhe ti krahasojë ato me tolerancat teknike të lejuara.

Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e të gjitha proceseve të punës si dhe ndjekja e rregullave të sigurimit teknik në punë dhe ruajtjes së mjedisit.

Vlerësimi i nxënësve bëhet më anë listës së kontrollit të përgatitur më parë.

Udhëzime për realizimin e Detyra 10: Përcaktimi i vend-ndodhjes në hartë.

Vendi ku do të realizohet: Në oborrin e shkollës .

Mjetet e punës që nevojiten: Hartë topografike, busull, letër kalk, mjetet e vizatimit.

Për kryerjen e detyrës nxënësi ka nevojë për: Detyra kryhet individuale.

Nga mësuesi do ti përcaktohen tre pika në terren. Nxënësi kryen në terren proceset e duhura të punës për të përcaktuar vendndodhjen e këtyre pikave në hartë. Orienton hartën nga veriu, orientohet me objektet që e rrethojnë në terren duke i përcaktuar vendin e tyre në hartë. Në lidhje me këto objekte ai përcakton dhe vend-ndodhjen e tij në hartë.

Vlerësimi do të përqendrohet:

1. Të orientojë hartën nga veriu në terren.
2. Të përcaktojë objektet karakteristike (ura, rruge, shtylla, etj.)
3. Të përcaktojë saktë pikën e dhënë në terren, duke iu referuar me objektet në terren, duke e gjetur atë(pikën) edhe se ku ndodhet në hartë.

Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e të gjitha proceseve të punës si dhe ndjekja e rregullave të sigurimit teknik në punë dhe ruajtjes së mjedisit.

Vlerësimi i nxënësve bëhet më anë listës së kontrollit të përgatitur më parë.

Udhëzime për realizimin e Detyra 11: Nxjerrja e koordinatave ortogonale nga harta.

Vendi ku do të realizohet: Në ambientin e kabinetit të gjeodezisë.

Mjetet e punës që nevojiten: Hartë topografike, mjetet e vizatimit, makinë llogaritëse.

Për kryerjen e detyrës nxënësi ka nevojë për: Detyra kryhet individuale.

Nga mësuesi do ti përcaktohen dy pika në hartë. Nxënësi kryen procedurën e duhur si për të matur distancat në hartë ashtu edhe për të llogaritur koordinatat e dy pikave. Si fillim, përcakton koordinatat e origjinës (fillimi i trapezit) në hartë, përcakton koordinatat e origjinës së pikës së dhënë në hartë duke u nisur nga koordinatat e origjinës së hartës dhe rrjetit kilometrik, mat dhe llogarit ndryshimin e koordinatave të pikës (Δx e Δy). Në përfundim, llogarit koordinatat ortogonale të pikës se dhënë.

Vlerësimi do të përqendrohet:

1. Të përcaktojë koordinatat e origjinës se hartës.

2. Të masë distancat e pikës në hartë.
3. Të përcaktojë koordinatat e origjinës së pikës së dhënë.
4. Të masë dhe të llogarisë ndryshimin e koordinatave.
5. Të llogarisë koordinatat ortogonale të dy pikave të dhëna

Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e të gjitha proceseve të punës si dhe ndjekja e rregullave të sigurimit teknik në pune dhe ruajtjes së mjedisit.

Vlerësimi i nxënësve bëhet më anë listës së kontrollit të përgatitur më parë.

Udhëzime për realizimin e Detyra 12: Nxjerrja e kuotës së një pikë mes dy izoipseve nga harta.

Vendi ku do të realizohet: Në ambientin e kabinetit të gjeodezisë.

Mjetet e punës që nevojiten: Hartë topografike, mjetet e vizatimit, makinë llogaritëse.

Për kryerjen e detyrës nxënësi ka nevojë për: Detyra kryhet individuale.

Nga mësuesi do të përcaktohen dy pika në hartë. Nxënësi kryen procedurat e duhura për të përcaktuar kuotat e dy pikave. Përcakton kuotën çdo izoipsi midis të cilave ndodhet pika. Mat në planin e hartës largësinë midis dy izoipseve. Gjen baras lartësinë midis izoipseve të shkruar në hartë. Mat largësinë nga pika deri tek izoipsi përkatës. Me formulat përkatëse gjen kuotën pikës A dhe pikës B.

Vlerësimi do të përqendrohet:

1. Të përcaktojë kuotën e dy izoipseve midis të cilave ndodhet pika A dhe B.
2. Të përcaktojë (gjejë në legjendën e hartës) baraslartësinë midis izoipseve.
3. Te masë largësinë në plan midis dy izoipseve.
4. Të masë largësinë nga pika e dhënë kundrejt dy izoipseve
5. Të llogarisë kuotën e pikës A dhe B.

Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e të gjitha proceseve të punës si dhe ndjekja e rregullave të sigurimit teknik në pune dhe ruajtjes së mjedisit.

Vlerësimi i nxënësve bëhet më anë listës së kontrollit të përgatitur më parë.

Udhëzime për realizimin e Detyra 13: Matjet për përcaktimin e koordinatave të pikës me metodën e prerjes para .

Vendi ku do të realizohet: Në ambientin e oborrit të shkollës.

Mjetet e punës që nevojiten: Teodolit, zhalona, librezë fushore.

Për kryerjen e detyrës nxënësi ka nevojë për: Detyra kryhet ne grup.

Nga mësuesi do të përcaktohen dy pika në terren, të cilave u njihen koordinatat ortogonale (që shërbejnë si pika të sistemit të referimit të Shqipërisë), si dhe pika se cilës do të përcaktohen koordinatat me këtë metodë. Nxënësi kryen procedurat e duhura për të përcaktuar koordinatat e një pike me prerje nga para. Nxënësi mat këndet me dy seri duke u centruar me teodolit në pikat e njohura ne terren (A dhe B) dhe vizuar në pikën që do të përcaktohen koordinatat ortogonale.

Vlerësimi do të përqendrohet:

1. Të centrojë dhe të horizontojë teodolit në pikat e dhëna A dhe B.
2. Të përcaktojë fillimin e çdo serie për matjen e këndeve horizontal-zbatim formule.
3. Të dijë procesin e punës për matjen e këndit në pikat e dhëna me seri.
4. Të regjistrojë të dhënat e matura në librezën fushore sipas formularit të matjes së këndeve me seri.

Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e të gjitha proceseve të punës si dhe ndjekja e rregullave të sigurimit teknik në pune dhe ruajtjes së mjedisit.

Vlerësimi i nxënësve bëhet më anë listës së kontrollit të përgatitur më parë.

Udhëzime për realizimin e Detyra 14: Matja e një distance me hapa.

Vendi ku do të realizohet: Në ambientin e oborrit të shkollës.

Mjetet e punës që nevojiten: Shirit- metër, zhalona, makinë llogaritëse.

Për kryerjen e detyrës nxënësi ka nevojë për: Detyra kryhet individuale.

Nga mësuesi do ti përcaktohen dy pika në terren midis të cilave do kryhet matja e distancës me hapa. Nxënësi kryen procedurat e duhura për të matur distancën midis dy pikave me hapa, e cila bazohet në përcaktimin si hap etalon - gjatësinë e një hapi çift, kryerjen e procesin matjes (ecje) me hapa nga nxënësi midis dy pikave vajtje dhe ardhje. Me pas në ambientin e kabinetit të gjeodezisë nxënësi llogarit distancën. Kontrolli mund të bëhet dhe me shirit-metër.

Vlerësimi do të përqendrohet:

1. Nxënësi duhet të përcaktojë gjatësinë e një hapi çift.
2. Të masë me hapa çift një distance të dhënë në terren.
3. Të llogarisë dhe të kontrollojë gjatësinë e kësaj distance.

Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e të gjitha proceseve të punës si dhe ndjekja e rregullave të sigurimit teknik në pune dhe ruajtjes së mjedisit.

Vlerësimi i nxënësve bëhet më anë listës së kontrollit të përgatitur më parë.

Udhëzime për realizimin e Detyra 15: Rilevimi ortogonal i oborrit të shkollës (duke matur 5 pika situacioni).

Vendi ku do të realizohet: Në ambientin e oborrit të shkollës.

Mjetet e punës që nevojiten: Shirit- metër, zhalona, eker, mjetet e vizatimit.

Për kryerjen e detyrës nxënësi ka nevojë për : Detyra kryhet në grup.

Nga mësuesi do t'i përcaktohen 5 pikat dhe një bazë AB për të kryer rilevimin ortogonal si dhe pasja e dy nxënësve ndihmës për kryerjen e procesit të rilevimit.

Nxënësi kryen procedurat e duhura për rilevimin ortogonal duke kërkuar nga dy nxënësit ndihmës kryerjen e detyrave si figurant. Fillimisht bëhet skica e zonës ku do të rilevohet. Vendoset ekerin sipas bazës AB dhe në drejtim të pikave detaje ndërton këndin 90° . Mat për çdo pikë detaje koordinatat (gjatësitë në bazën AB si vlerë Y dhe përgjatë pingules me këtë bazë si vlere X. Madhësitë X dhe Y maten me shirit- metër dhe hidhen ne librezën fushore.

Vlerësimi do të përqendrohet:

1. Nxënësi duhet të ndjekë procedurën e punës për të kryer ne terren këtë rilevim.
2. Të vizatojë skicën e terrenit.
3. Të përdorë ekerin për të ndërtuar këndin 90° .
4. Të masë koordinatat e çdo pike detaje ne terren (X, Y).
5. Të plotësojë librezën fushore

Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e të gjitha proceseve të punës si dhe ndjekja e rregullave të sigurimit teknik në pune dhe ruajtjes së mjedisit.

Vlerësimi i nxënësve bëhet më anë listës së kontrollit të përgatitur më parë.

Udhëzime për realizimin e Detyra 16: Realizimi i llogaritjes së një libeze takimetrike me pesë pika në kabinetin e gjeodezisë.

Vendi ku do të realizohet : Në ambientin e kabinetit të gjeodezisë.

Mjetet e punës që nevojiten: Libreza fushore e matjeve, makinë llogaritëse me funksione trigonometrike.

Për kryerjen e detyrës nxënësi ka nevojë për : Detyra kryhet individuale.

Nga mësuesi do ti jepet nxënësit një libeze fushore me matje të kryera në terren të të 5 pikave. Nxënësi do të kryejë llogaritjet me tabelë : të distancës së pjerrët, distancës horizontale, disnivelin si dhe kuotën e çdo pike.

Vlerësimi do të përqendrohet:

1. Nxënësi duhet të llogarisë distancën e pjerrët.
2. Të llogarisë distancën horizontale.
3. Të llogarisë disnivelin.
4. Të llogarisë kuotën e çdo pike.
5. Të plotësojë librezën fushore me llogaritjet e kryera.

Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e të gjitha proceseve të punës si dhe ndjekja e rregullave të sigurimit teknik në pune dhe ruajtjes së mjedisit.

Vlerësimi i nxënësve bëhet më anë listës së kontrollit të përgatitur më parë.

Udhëzime për realizimin e Detyra 17: Llogaritja e elementeve të kthesës.

Vendi ku do të realizohet: Në ambientin e kabinetit të gjeodezisë.

Mjetet e punës që nevojiten: Mjetet e vizatimit, makinë llogaritëse me funksione trigonometrike.

Për kryerjen e detyrës nxënësi ka nevojë për: Detyra kryhet individuale.

Nga mësuesi do ti jepen dy të dhëna, këndi i kthesës dhe shpejtësia. Nxënësi do të kryejë llogaritjet për të gjetur: rrezën, tangenten, bisektricen, gjatesin e harkut.

Vlerësimi do të përqendrohet:

1. Nxënësi duhet të dijë të llogarisë rrezën e kthesës (R).
2. Të llogarisë tangenten e kthesës (T).
3. Të llogarisë bisektricen apo përgjysmoren (B).
4. Të llogarisë gjatësinë e harkut (K).

Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e të gjitha proceseve të punës si dhe ndjekja e rregullave të sigurimit teknik në punë dhe ruajtjes së mjedisit.

Vlerësimi i nxënësve bëhet më anë listës së kontrollit të përgatitur më parë.

Udhëzime për realizimin e Detyra 18: Realizimi i piketimit të një objekti në terren me prerje këndore në oborrin e shkollës.

Vendi ku do të realizohet: Në oborrin e shkollës dhe kabinetin e gjeodezisë

Mjetet e punës që nevojiten : Dy Teodolitë, dy trekëmbështa, zhalon, plan topografik i oborrit të shkollës në shkallën 1: 500.

Për kryerjen e detyrës nxënësi ka nevojë për:

Detyra kryhet në grup.

Detyra kryhet si veprimtari praktike e 2 ose 3 nxënësve. Për këtë nxënësit i mundësohet ambienti i përshtatshëm për matjet e nevojshme (në oborrin e shkollës), si dhe prezenca e dy nxënësve ndihmës për kryerjen e procesit të piketimit me metodën e prerjes këndore. Nga mësuesi i vihet në dispozicion një plan topografik i oborrit të shkollës të shkallës 1 : 500 dhe i përcaktohen 2 pika stacionimi për centrimin e teodolitëve dhe 1 pikë (që do të shërbejë si pika e dhënë për piketim me metodën e paracaktuar).

Vlerësimi do të përqendrohet :

1. Nxënësi duhet të nxjerrë të dhënat e nevojshme nga detyra e përcaktuar tek plani i oborrit të shkollës i Shk 1:500, vlerat e këndeve të nevojshëm për metodën e piketimit me prerje tërthore.
2. Të përgatisë vendin e punës duke përcaktuar pikat e centrimin të teodolitëve duke kryer centrimin dhe horizontimin e njerit prej tyre (atë instrument që do të punojë vetë). Pasi tek teodoliti i dytë do të jetë nxënësi i dytë ndihmës.
3. Nxënësi duhet të ndjekë procedurën e horizontimit të instrumentit, që do të përdorë vetë.
4. Të kryejë procedurën e piketimit të pikës duke orientuar ndihmësin e vet për ta futur në vijën e piketimit. Komunikimi teknik mes topografit dhe figurantit.

Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e të gjitha proceseve të punës si dhe ndjekja e rregullave të sigurimit teknik në punë dhe ruajtjes së mjedisit.

Vlerësimi i nxënësve bëhet më anë listës së kontrollit të përgatitur më parë.

Udhëzime për realizimin e Detyra 19: Realizimi i nivelimi të sipërfaqes së ndërtimit me katrorë në oborrin e shkollës.

Vendi ku do të realizohet :

Në oborrin e shkollës dhe në kabinetin e gjeodezisë.

Mjetet e punës që nevojiten: Teodolit, trekëmbësh, zhalon, plan i oborrit të shkollës në shkallën 1: 500, shirit-metër, nivelë + trekëmbësh, lata.

Për kryerjen e detyrës nxënësi ka nevojë për: Detyra kryhet në grup.

Detyra kryhet si veprimtari praktike e 2 ose 3 nxënësve. Për këtë nxënësit i mundësohet ambienti i përshtatshëm për matjet e nevojshme. Nga mësuesi i bëhet e mundur një plan topografik i oborrit të shkollës të shkallës 1:500 dhe i përcaktohet detyra për sheshimin me vetëm me 4 katrorë.

Vlerësimi do të përqendrohet :

1. Nxënësi duhet të ndërtojë rrjetin e katrorëve në oborrin e shkollës dhe të masë kuotat e kulmeve të katrorëve.
2. Të vizatojë skicën fushore të rrjetit të katrorëve ku të vendosë edhe vlerat e matjeve (kuotat).
3. Nxënësi duhet të ndjekë procedurën e llogaritjes të kuotës H_0 të planit të sheshimit me kushtin e balancimit të gërmim-mbushjeve.
4. Nxënësi llogarit volumet e dheut (gërmim-mbushje).

Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e të gjitha proceseve të punës si dhe ndjekja e rregullave të sigurimit teknik në punë dhe ruajtjes së mjedisit.

Vlerësimi i nxënësve bëhet më anë listës së kontrollit të përgatitur më parë.

Udhëzime për realizimin Detyra 20: Realizimi i piketimit të kanalit me kuotë të kërkuar në oborrin e shkollës.

Vendi ku do të realizohet: Në oborrin e shkollës.

Mjetet e punës që nevojiten: Nivelë, trekëmbësh, latë, piketa, lapustila shënimi.

Për kryerjen e detyrës nxënësi ka nevojë për: Detyra kryhet ne grup.

Detyra kryhet si veprimtari praktike e 2 nxënësve. Për këtë nxënësit i mundësohet ambienti i përshtatshëm për matjet e nevojshme (në oborrin e shkollës), si dhe pasja e një nxënësi ndihmës për kryerjen e procesit të piketimit të kanalit me kuotë të kërkuar. Nga mësuesi i jepet kuota fillestare si dhe pjerrësia në përqindje e kanalit të kërkuar si dhe i përcaktohet 1 pikë (që do të shërbejë si pika e dhënë fillestare për fillimin e piketimit të kanalit me kuotë të kërkuar).

Vlerësimi do të përqendrohet:

1. Nxënësi duhet të nxjerrë të dhënat e nevojshme nga detyra e përcaktuar (kuotat që dalin duke respektuar pjerrësinë e kërkuar ne bazë të formulës përkatëse).
2. Të përgatisë instrumentin për punë, nivelën (Nxënësi duhet të ndjekë procedurën e horizontimit të instrumentit, që do të përdorë vetë).
3. Kryen procedurën e piketimit të kanalit me kuotë të kërkuar.

Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e të gjitha proceseve të punës si dhe ndjekja e rregullave të sigurimit teknik në punë dhe ruajtjes së mjedisit.

Vlerësimi i nxënësve bëhet më anë listës së kontrollit të përgatitur më parë.

Udhëzime për realizimin e Detyra 21: Llogaritja e volumit të rezervuarit.

Vendi ku do të realizohet: Në kabinetin e gjeodezisë.

Mjetet e punës që nevojiten: Një hartë e shkallës 1:10,000 ose 1:25,000, planimetri polar, librezë fushore, makinë llogaritëse, mjete kancelarie.

Për kryerjen e detyrës nxënësi ka nevojë për: Detyra individualisht

Detyra kryhet si veprimtari praktike individuale. Për këtë nxënësit i mundësohet planimetri polar, dhe mjetet e tjera të nevojshme kancelarie për kryerjen e detyrës. Nga mësuesi i bëhet e mundur një hartë topografike shkallës 1:10,000 ose 1:25,000 si dhe i përcaktohet vija e përmbytjet në hartë.

Vlerësimi do të përqendrohet:

1. Nxënësi duhet masë sipërfaqet e planeve të izoipsit, nga izoipsi i tabanit të rezervuarit deri tek vija e përmbytjes me planimetër polar.
2. Të llogarisë volumin e rezervuarit duke përdorur formulat përkatëse.

Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e të gjitha proceseve të punës si dhe ndjekja e rregullave të sigurimit teknik në punë dhe ruajtjes së mjedisit.

Vlerësimi i nxënësve bëhet më anë listës së kontrollit të përgatitur më parë.

Udhëzime për realizimin e Detyra 22: Plotësimi i librit të skicave dhe i librit të tokës..

Vendi ku do të realizohet: Në kabinetin e gjeodezisë.

Mjetet e punës që nevojiten: Një hartë ose plan kadastral i shkallës 1:5.000 ose 1:2.000, planimetri polar, fletë të librit të skicave dhe fletë të librit të tokës, makinë llogaritëse, mjete kancelarie.

Për kryerjen e detyrës nxënësi ka nevojë për: Detyra individuale.

Detyra kryhet si veprimtari praktike individuale. Për këtë nxënësit i mundësohet planimetri polar, dhe mjetet e tjera të nevojshme kancelarie për kryerjen e detyrës. Nga mësuesi i bëhet e mundur një plan kadastral shkallës 1:5.000 ose 1:2.000 si dhe i përcaktohen jo me shumë se 6 parcela pronash.

Vlerësimi do të përqendrohet:

1. Nxënësi duhet masë sipërfaqet e parcelave me planimetër polar, ose t'i llogarisë me metodën gjeometrike sipërfaqet e parcelave. Mënyra e përzgjedhjes vlen si mjet vlerësimi duke përcaktuar njohuritë e tij të mbledhjes së të dhënave kadastrale. (metoda e këqyrjes në vend)

2. Të plotësoje të dhënat tek libri i skicave: sipërfaqen, llojin e kulturës, pjerrësinë, veprat bonifikuese, pronarin (plotësohet fleta e parapërgatitur nga mësuesi).

3. Të plotësojë të dhënat tek libri i Tokës duke marrë të dhënat nga libri i skicave dhe duke plotësuar edhe elementët e tjerë të këtij libri (plotësohet fleta e parapërgatitur nga mësuesi).

Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e të gjitha proceseve të punës si dhe ndjekja e rregullave të sigurimit teknik në punë dhe ruajtjes së mjedisit.

Vlerësimi i nxënësve bëhet më anë listës së kontrollit të përgatitur më parë.